



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:152722

Datë: 11.06.2024

Numri i dokumentit: 05807459

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.627/22

GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL, me gjyqtarin e vetëm gjykues Leon Perlaska, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Teuta Spahija, në çështjen penale kundër të pandehurit Q. GJ. për shkak të veprës penale “Kanosje” nga neni 181 par 2 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti për Krime të Përgjithshme PP/II.nr.1336/22, të datës 25.07.2022, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 06.06.2024 në prezencë të prokurores së shtetit Arlinda Nallbani Gacaferi, te pandehurit Q. GJ. si dhe përf.i autorizuar i të dëmtuarës av. Artan Kastrati, me datë 06.06.2024 shpalli, ndërsa me datë 11.06.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

Q. GJ. i lindur më ....., në K. Pejë, në fsh. .... i Madh-Komuna Pejë, jeton në Rr. “.....” nr.56, Pejë, nga babai ....., dhe nëna ....e vajzërisë ....., ka te kryer shkollën e mesme, ka të kryer dy vite të fakultetit gjuhë angleze, punon në call-center, i pa martuar, me numër personal ....., i gjendjes se mesme ekonomike, boshnjak, shtetas i Republikës së Kosovës:

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Me dt. 29.06.2022, rreth orës: 10:20 në Rr. “.....” K. Pejë pikërisht në shtëpinë e të pandehurit, me qëllim të frikësimit seriozisht e kanos me fjalë se do ta privoj nga jeta te dëmtuarën ....Gj....., te cilën e ka motër, në atë mënyrë që derisa e dëmtuara ishte te i pandehuri, i pandehuri i drejtohet

me fjalët kanosëse: “Killosharica e keqe, un nuk foli me ty, a e din qe un ty të ndaj 5 copa qetash qetu të ndaj përgjysmë”, ku me këto fjalë te e dëmtuara shkakton frikë se do ti ndodhë diçka e keqe nga i pandehuri e cila rastin e raporton në polici.

- Me çka ka kryer veprë penale “Kanosje” nga neni 181 par 2 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata duke u bazuar në nenin 4, 7, 17, 69, 70, 81, 82 dhe 181 par. 2 të KPRK-së, si dhe nenit 364 të KPPRK-së, të pandehurit i shqipton:

### VËREJTJE GJYQËSORE

- I. Të pandehurit Q. GJ. i bëhet me dije se ka kryer veprë penale të dënueshme dhe nëse serish kryen ndonjë veprë të tillë, gjykata do të shqiptoi sanksionin më të rëndë penal.
- II. I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € (njëzetë) euro dhe ne emër të programit për kompensimin e viktimave të krimit te paguaj shumën prej 20 (njëzetë) euro në afat prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

### ARSYETIM

A. Historiku i çështjes dhe vendimi ne lidhje me fajësinë;

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, kundër të pandehurit Q. GJ. ka ngrit aktakuzë PP/II.nr.1336/22, të datës 25.07.2022, për shkak të veprës penale veprës penale “Kanosje” nga neni 181 par 2 të KPRK-së.

Kjo gjykatë me datë 06.06.2024 e mbajti seancën e shqyrtimit fillestar në të cilën prezantuan prokurorja e shtetit Arlinda Nallbani Gacaferi, i pandehuri Q. GJ. dhe përf.i autorizuar i të dëmtuarës av. Artan Kastrati, në të cilën seancë i pandehuri u deklarua se e pranon fajësinë për veprën penale qe i vihet në barrë.

Pas marrjes së mendimit të prokurorit të shtetit dhe përf.i autorizuar i të dëmtuarës dhe në kuptim të nenit 242 par.2 dhe 6 të KPPRK-së, gjykata vendosi qe të aprovoj pranimin e fajësisë të bërë

nga i pandehuri, pasi qe është e qartë se i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht, pranimi mbështetet në faktet e çështjes qe përmban aktakuza dhe provat e pranueshme qe e mbështesin aktakuzën dhe se aktakuza nuk përmban shkelje të qarta ligjore ose gabime faktike.

Pas aprovimit të pranimi të fajësisë nga ana e gjykatës, prokurorja e shtetit lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit deklaroi “ Pasi i pandehuri pranoi fajësinë e ky pranimi fajësie gjen mbështetjen në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, unë mbetem në tersi pranë aktakuzës dhe cilësimit juridik dhe i propozoi gjykatës qe te pandehurin ta shpalle fajtorë, ta dënoj sipas ligjit dhe me rastin e marrjes së vendimit mbi dënim pranimi i fajësisë të merret si rrethana lehtësuese”.

Përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarës av. Artan Kastrati nuk ka diçka për të shtuar.

I pandehuri Q. GJ. deklaroi “ Ne jemi pajtuar që nga ajo kohë nuk kemi pasë probleme tjera, e gjithë kjo ka ardhur ndoshta për shkak të problemeve familjare që i kemi pasur për shkak të sëmundjes të prindërve babait me sëmundje të shizofrenisë, nëna e sëmurë, e gjithashtu edhe motra është me epilepsi, ka qenë një moment që kam dalë nga vetja, për shkak të gjitha problemeve dhe premtoj se këto nuk do të përsëriten në të ardhmen”.

B. Vendimi lidhur me dënimin;

Gjykata kur vendosi të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u bazua në dispozitat 4, 7, 17, 69, 70, 81, 82 dhe 181 par. 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës ( 06/L-074) dhe atë duke vlerësuar rrethanat lehtësues dhe renduese te çështjes.

Për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i pandehurit ligjvënësi ka paraparë mundësin e shqiptimit të dënimit me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit, e në këtë rast gjykata ndaj të pandehurit vendosi qe të shqiptoj vërejtje gjyqësore dhe të njëjtit i bëhet me dije se ka kryer vepër penale të dënueshme dhe nëse serish kryen ndonjë vepër të tillë, gjykata do të shqiptoi sanksionin më të rëndë penal.

Duke i analizuar faktet e çështjes, gjykata erdhi në përfundim se në lidhje me të pandehurin nuk kemi fare rrethana renduese, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata e gjeti pranimin e fajësisë të

bërë nga të pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestar dhe keqardhjen e shfaqur nga i pandehuri me rastin e pranimit të fajësisë, hera e parë që ka ra ndeshë me ligjin, si dhe faktin se me të dëmtuarën kanë rregulluar raportet menjëherë pas veprës, ku duke u nisur nga këto rrethana dhe në kuptim të nenit 38 dhe 42 të KPRK-së gjykata vendosi që ndaj të pandehurit të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kur u vendos për Vërejtjen gjyqësore gjykata u bazua në nenin 81, 82 par.2 të KPRK-së.

Andaj marrë për bazë të gjitha këto rrethana të pandehurit i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë vërejtja gjyqësore nga neni 82 të KPRK-së, për shkak se dispozita e nenit 82 par.2 të KPRK-së, parasheh se kryesit të veprës penale mund të shqiptohet Vërejtja Gjyqësore sipas par.2 të nenit 82, për vepra penale për të cilat është paraparë dënimi me burgim deri në një (1) vit ose dënimi me gjobë, në rastet kur veprat e tilla janë kryer në rrethana lehtësuese të cilat i bëjnë veprat penale veçanërisht të lehta, në rastin konkret i pandehuri ka kryer vepra penale “Kanosjes” nga neni 181 par. 2 të KPRK-së, ku parashihet dukshmëria dënim me gjobë ose me burgim deri në 1 (një) vite.

Gjykata ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar si në dispozitiv të aktgjykimit, është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljet dhe rrethanat e kryesit sipas nenit 69 par.1 të KP-së, shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e saj, me bindje se dënimi i tillë do të ndikojë në risocializimin dhe riedukimin e kryesve, si dhe do të ndikojë tek të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit sipas nenit 38 të KP-së, e duke pasur parasysh të gjitha rrethanat në lidhje me veprën dhe kryesin, vërejtja gjyqësore është e mjaftueshme për të arritur qëllimin e dënimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale për paushallin gjyqësor u mor në kuptim nenit 449 par.1 dhe par.2 nën paragrafi 2.6 dhe nenin 452 par.1 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me taksën për kompensimin e viktimave të krimit, u mor në bazë të nenit 36 par.3 pika 1 të Ligjit 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit.

Andaj, duke u mbështetur në fakte e parashtruara dhe dispozitat ligjore nga neni 364 dhe 369 të KPPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMLORE PEJË**

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.627/22, me datë 11.06.2024

Bashkëpunëtorja profesionale:

Teuta Spahija

Gjyqtari i vetëm gjykues:

Leon Përlaska

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga pranimi i të njëjtit, ankesa paraqitet në këtë gjykatë për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.